REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2009

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke njohur e vlerësuar rolin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare në Republikën e Shqipërisë;

- Duke vlerësuar kontributin e tij në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së këtyre tregjeve;

- Duke vlerësuar rolin e këtij autoriteti për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut, në përgjithësi, një informacion cilësor e profesional mbi këto tregje;

- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të:

- Përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistues, duke reflektuar kështu zhvillimet më të fundit të legjislacionit europian, që rregullojnë tregjet financiare jobankare, në përputhje me planin kombëtar të zbatimit të MSA-së, si dhe duke forcuar rolin e Autoritetit, në kuadër të funksionit të tij rregullues;

- Përdorimit të elementeve të reja të modelit të mbikëqyrjes me bazë risku, të cilat ndihmojnë në analizimin e gjendjes financiare dhe treguesve të operatorëve financiarë;

- Projektimit, ndërtimit dhe administrimit të sistemeve informatike, në mbështetje të strategjisë së Autoritetit, për përmbushjen e nevojave të mbikëqyrjes së tregut, operatorëve të tij dhe mbrojtjen e konsumatorëve;

- Rritjes së cilësisë dhe transparencës së informacionit për një komunikim më efektiv me publikun në tërësi, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve, si dhe edukimin e segmenteve të ndryshme të tregut dhe të konsumatorëve për produktet financiare të institucionit;

- Vendosjes dhe thellimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në tërheqjen e politikave më të mira apo ofrimin e asistencës teknike të nevojshme.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2010 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Rritjen dhe konsolidimin e pozicionit të Autoritetit në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jobankare;

- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, duke garantuar, në të njëjtën kohë, edhe sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur;

- Plotësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e në veçanti atij nënligjor, në zbatim të akteve ligjore të miratuara deri tani, në përputhje me praktikat e vendeve të tjera dhe direktivat e Bashkimit Europian;

- Përgatitjen e kuadrit ligjor dhe marrjen e masave organizative, me synim përmirësimin e raportit dëme/prime;

- Nxitjen e fushatave edukuese për publikun, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për përfitimet nga produktet dhe shërbimet financiare, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe integritetit të tregjeve;

- Krijimin e hapësirave të nevojshme, që lehtësojnë hyrjen e investitorëve dhe kapitalit të huaj në tregjet financiare jobankare.

20 maj 2010